

**Bashkia:** MALËSI E MADHE

**Kryetar:** TONIN MARINAJ

**Fusha:** INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

**Premtime:**

1. Do të rikonstruktohen rrugët në fshatra
2. Do të rikonstruktohen rrugët e qytetit
3. Do të kryhet rikonstruktion i sistemit të ujësjellësit për të pasur ujin e pijshëm 24 orë në territorin e bashkisë
4. Do të hartohet plani rregullues për të gjithë Malësinë e Madhe
5. Brenda mandatit 4 vjeçar, do të bëhet rregullimi dhe sistemimi i të gjitha qendrave të njëjësive bashkiake
6. Do të sistemohen dhe mirëmbahen rrugët ekzistuese, që lidhin njësitë administrative me qendrën e bashkisë
7. Do të kërkohet konsiderimi i ndërtimeve të deritanishme dhe do të mbështetet proçesi i legalizimeve
8. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të bardha e të zeza, do të përmirësohen ose ndërtohen aty ku mungojnë dhe gjithashtu do të hartohet projekti për përpunimin e ujërave të zeza me qëllim që të mos derdhen në liqen
9. Në bashkëpunim me biznesin privat, do të punohet për krijimin e një linje të rregullt dhe me orar të transportit publik nga Kopliku në Shkodër dhe anasjelltas. Gjithashtu, do të ndërtohen pikat e stacioneve të autobuzit përgjatë rrugës Koplik-Shkodër dhe Koplik – Hani i Hotit, si dhe stacioni qendror i autobuzit në Koplik
10. Do të hapen ambulancat në fashtrat që mungojnë dhe do të mbështeten me personel, ndërkohë që do të rikonstruktohen ambulancat ekzistuese që kanë nevojë për riparime
11. Në administratën e bashkisë do të ketë të paktën një punonjës, i cili do të punojë, me kohë të plotë dhe funksion të mirëpërcaktuar për të mbështetur qytetarët për rastet kur kanë nevoja shëndetësore të veçanta
12. Do të kryhet urbanizimi i qytetit të Koplikut, si qendër administrative e Bashkisë
13. Do të punohet për krijimin e një Qendre tregëtare moderne në qytetin e Koplikut
14. Do eliminohet mungesa e personelit në spitalin e Koplikut, me mbështetjen e Qeverisë dhe të Fondit për Shëndetësinë, duke synuar të sillen specialistë nga Spitali Rajonal i Shkodrës, që të ofrohet shërbimi në një apo më shumë specialitete
15. Do të kryhet rruga që lidh Bratoshin me Rapshën dhe Hotin

**Fusha:** ARSIM/KULTURË/SPORT

**Premtime:**

1. Do të kryhet mirëmbajtja, rikonstrukcioni, plotësimi i bazës materiale dhe kushteve optimale në të gjitha shkollat e bashkisë

2. Do të punohet për uljen e numrit të nxënësve në klasa në territorin e bashkisë, në mënyrë që të mos ketë klasa të arsimit fillor me më shumë se 25 nxënës, dhe në arsimin e mesëm, jo më shumë se 30 nxënës për klasë
3. Do të mbështetet arsimi profesional, duke hapur si fillim klasa profesionale në fushën e teknikave buqësore e blegtorale, hidraulike, elektrike etj
4. Do të mundësohen bursa për nxënësit më të dalluar të gjimnazeve dhe shkollave të mesme të bashkisë
5. Do të sigurohet transporti i mësuesëve dhe nxënësve për zonat e thella të bashkisë
6. Bashkia në bashkëpunim me qeverinë qendrore dhe Federatën Shqiptare të Futbollit, do të mundësojë ndërtimin e një stadiumi me standarde të pranueshme për ekipin e Veleçikut
7. Do të krijohen kushte për sportin e Volejbollit, Basketbollit, Mundjes, Peshëngritjes, Notit, Alpinizmit dhe Skive, Hipizmin e Parashutizmit, si dhe të gjitha sportet e tjera
8. Do të realizohet brenda këtij mandati hapja e një muzeu për zonën
9. Do të kryhet gjallërimi i jetës kulturore, në partneritet me biznesin privat, duke hapur shtëpinë e kulturës dhe kinemanë në Koplík
10. Do të mundësohet ndërtimi i një shkolle të re 9-vjeçare në Koplík
11. Brenda 4 viteve të ardhshme do të ndërtohet Qendra e Kulturës në Bajzë
12. Qyteza e Bajzës do të konceptohet si qendër e kulturës dhe traditave kulturore e historike për krahinën

### **Fusha: MJEDIS/TURIZËM**

#### **Premtime:**

1. Do të caktohet dhe ndërtohet një landfill (fushë e përpunimit të mbetjeve urbane), për të gjithë bashkinë
2. Do të zbatohen projekte për caktimin e pikave të grumbullimit në të gjitha zonat e banuara, duke i dhënë përparësi zonave me prioritet turizmin si: Bregu i liqenit, Razma, Boga, Lëpusha, Fushë Zeza, Troshani, Vermoshi etj.
3. Do të mbështet zhvillimi i Turizmit Malor (Razma, Boga, Vermoshi Lepusha, Fushë Zeza, etj.), në kuadër të planit për zhvillimin e Alpeve të Shqipërisë, ku më shumë se 70 % e zonave turistike malore të Alpeve të Shqipërisë, shtrihen në zonën e Malësisë së Madhe. Projekti i zhvillimit të turizmit në këto zona, do të realizohet në bashkëpunim me qeverisjen qendrore dhe partnerët e huaj, si dhe biznesin privat
4. Do të kryhet rritja e kapaciteteve të akomodimit të turistëve nëpërmjet mbështetjes me projekte, si dhe do të ofrohen lehtësira me qëllim që të krijohen ambiente të reja dhe bashkëkohore, për akomodimin e turistëve vendas e të huaj
5. Do të kryhet hartëzimi i zonave turistike, do të hartohet guida turistike për të gjitha zonat, do të përcaktohen guidat e lejueshme, me qëllim mbrojtjen e florës dhe faunës, dhe do të përcaktohet sinjalistika e nevojshme për rrugët e këmbësorëve, biçikletave, etj.
6. Do të zhvillohet turizmi familjar nëpërmjet mbështetjes bashkiake, por edhe në koordinim me agjensitë shtetërore dhe private, me qëllim që për banorët e zonave

turistike malore, të jepen kredi të buta, për të plotësuar kushtet optimale, lidhur me akomodimin e turistëve, të cilët preferojnë turizmin familjar

7. Do të mbështetet Turizmi Liqenor nëpërmjet ndërtimit të rrugës së bregut të liqenit të Shkodrës në të gjithë gjatësinë e tij, në shtrirjen e territorit të Malësisë së Madhe, me vend ecje dhe vrapimi për këmbësorët, për ecje dhe shëtitje me biçikleta dhe për automjetet. Do ketë pika të organizuara dhe të përcaktuara për lokalet e shërbimit me konstruksion të lehtë dhe sa më të lidhur me natyrën. Krijimi dhe përshtatja e 2 deri 3 vendeve dhe gjireve për plazhe liqenore. Përcaktimi i vendeve të zhvillimit të sporteve ujore
8. Do të mbështetet Turizmi Kulturor nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e Ministrisë së Kulturës, lidhur me: a) kërkimet arkeologjike në Marshej, rritjen e interesit dhe bërjen të vizitueshme në harkun kohor të 4 vjeçarit. b) konkursi i bukurisë (logu i bjeshkëve) do të zgjerohet duke tërhequr pjesëmarrje të zonave shqiptare të Malit të Zi, Pejës në Kosovë dhe Tropojës, historikisht pjesë, apo të lidhura me Malësinë e Madhe
9. Do të kryhet pastrimi i qytetit
10. Do të kryhen fushat e skive në Vermosh, në partneritet me biznesin privat, vendas apo të huaj

#### **Fusha: BUJQËSI**

#### **Premtime:**

1. Do të kryhet pastrim i kanaleve kulluese në territorin e bashkisë
2. Do të bëhet e mundur shfrytëzimi i potencialeve ujitëse në masën 100%, por do të vendoset në objektiva edhe rritja e këtij potenciali
3. Në zonat fushore, do të nxitet procesi i bashkëpunimit ndërmjet fermerëve, me qëllim krijimin e kushteve për intensifikimin e bujqësisë, pasi do të sillte kosto më të ulët prodhimi, produkte më cilësore dhe më të larta, si dhe mundësi e organizuar e shitjes së produkteve
4. Në bashki do të krijohet një strukturë e veçantë, e specializuar që do të jetë përgjegjëse për koordinimin e mbjelljeve për bimët bujqësore, bimë medicinale dhe eterovajore; Kjo strukturë, pasi të ketë bërë studimet dhe kërkimet e tregjeve, në bashkëpunim edhe me kompanitë rajonale të grumbullimit, do të orientojë kulturat dhe sasi të mundshme, në bazë të kapaciteteve përthithëse të tregjeve brenda e jashtë vendit, me qëllim që të mos mbeten produkte stok dhe pa u shitur
5. Do të kryhet nxitja e mbarështrimit të bagëtive, e shoqëruar edhe me shtimin e kapaciteteve të përpunimit dhe grumbullimit të produkteve blegtorale
6. Do të zgjidhet problemi i pronësisë në tokat bujqësore
7. Do të ndihmohen fermerët për të përfutur fonde nga Fondi i Zhvillimit e më gjerë
8. Do të 5-fishohet sipërfaqja e ujitshme
9. Tregjet në Koplik, por edhe në zona të tjera, do të jenë të disiplinuar dhe me standarte të vendeve të BE-së (do të realizohet brenda 2 vjeçarit të parë të mandatit)

#### **Fusha: TRANSPARENCA**

### **Preftime:**

1. Do të sigurohet shërbimi edhe në fshatin më të thellë të Bashkisë, ndër të tjera kjo do të realizohet edhe me anë të digjitalizimit të të gjitha njësive administrative
2. Do të kryhet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, me anë të referendumeve lokale, kur ato të jenë të nevojshme
3. Do të sigurohet hapja e zyrës së trajtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, ku do përcaktohen rregulla dhe afate strikte për shqyrtimin e tyre
4. Do të kryhet krijimi i departamentit të zhvillimit të zonës, me objektiva të mirë-përcaktuara, kryesisht për hartimin e projekteve dhe dhënien e rekomandimeve për burimet e financimit

### **Fusha: SHËRBIMET SOCIALE**

#### **Preftime:**

1. Bashkia, në bashkëpunim me qeverinë qendrore që për fëmijët jetimë dhe familjet në nevojë, të përballojë në masën 100% financimin e teksteve shkollore

### **Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM**

#### **Preftime:**

1. Do të kryhet rishikimi i sistemit të taksave lokale, me synim uljen, ku të jetë e mundur, dhe mirëadministrimin e tyre
2. Shpallja e zonës së lirë ekonomike, do të krijojë favore për biznese të ndryshme, që të zhvillojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë. Do të mundësohet hapja e kurseve të ndryshme të kualifikimit të burimeve njerëzore, kjo me qëllim, që fuqia potenciale punëtore, të jetë mjaftueshëm e kualifikuar, për t'u vënë në shërbim të nevojave të bizneseve, të cilat do të ngrihen në këtë kuadër
3. Do të nxiten e sipërmarrjet lokale, të specializuara për prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.
4. Tregu për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, do të ngrihet brenda standarteve të pranueshme
5. Bashkia do të nxisë dhe përkrahë të gjitha ato biznese, që krijojnë mundësi punësimi për sa më shumë banorë të zonës tonë, të cilat do të gjejnë tek bashkia të gjitha llojet e lehtësirave
6. Do të kryhet përmirësimi i transportit të qytetarëve, në partneritet me privatin, brenda zonave të bashkisë, por edhe në lëvizjet ndër-qytetase, të kenë të gjitha lehtësirat për lëvizje me kosto sa më të ulët të mundshme